REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
FINANCA

Nr. 3939/1 Prot. Date 16/10/2026.

Lenda : Relacion për Projekt Vendimin Nr.18 Date 16.10.2026 Rishpërndarje në buxhetin e Bashkisë Has në transfertën e pakushtezuar për vitin 2026.

Bazuar në, Ligjin Nr.139/2015, date 17.12.2015 "Për Veteqeverisjen Vendore", Ligjin Nr.68/2017 "Per Financat e Veteqeverisjes Vendore", Ligjin Nr.9936, date 26.06.2008 "Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, Ligjit Nr. 87/2025 per buxhetin e vitit 2026", Udhëzimit Plotësues Nr.2 datë 14.01.2026 "Për zbatimin e buxhetit 2026", paraqitet për miratim Rishpërndarja e fondeve buxhetore e vitit 2026; ky projektvendim synon të mundësojë përdorimin sa më efektiv të fondeve buxhetore në dispozicion, në përputhje me nevojat e njësive shpenzuese dhe prioritetet e institucionit, duke siguruar mbulimin e nevojave për shpenzime të domosdoshme gjatë zbatimit të buxhetit të vitit 2026. Rishpërndarja e propozuar realizohet brenda fondeve të transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme të Bashkisë Has për vitin 2026.

Qëllimi i rishpërndarjes
Rishpërndarja synon përshtatjen e fondeve buxhetore me nevojat konkrete të programeve dhe shërbimeve të Bashkisë Has, duke rialokuar fondet nga zërat ku parashikohet pakësim drejt zërave ku kërkohet financim, pa ndryshuar totalin e transfertës së pakushtëzuar të përfshirë në këtë rishpërndarje.

1. Pakësimet e fondeve buxhetore

Në projektvendim parashikohen pakësime në shumën totale prej 6,647,191 lekësh, të cilat përfshijnë zërat e mëposhtëm: Paga, Pajisje për përdorim policor, në programin, Uniforma për punonjësit, Sigurime shoqërore, Materiale për pastrim, Strehim social, Energji elektrike, Mirembajtje permiresim zyra me nje ndalese. Këto pakësime përbëjnë burimin e fondeve që do të rishpërndahen në zërat e tjerë të buxhetit, sipas përcaktimeve të projektvendimit.

2. Shtesat e fondeve buxhetore

Fondet e pakësuara rishpërndahen në shumën totale prej 6,647,191 lekësh, për financimin e nevojave të mëposhtme: Paga dhe sigurime shoqërore për programet përkatëse, në shumën totale prej 2,023,000 lekësh, Energji elektrike, në shumën 337,191 lekë, Transfertë kapitale për aksionar Shruk, në shumën 606,000 lekë, Dru zjarri, në shumën 181,000 lekë, Studim-projektim për rrugën e Cahanit, në shumën 2,000,000 lekë, Lëndë djegëse për mjetet përkatëse, në shumën 1,000,000 lekë si dhe 500,000 Lekë në ndihmë financiare familjeve në nevojë me problematika shëndetësore dhe ekonomike.Shpërndarja e fondeve sipas programeve dhe llogarive ekonomike synon mbulimin e nevojave të evidentuara për vazhdimësinë e shërbimeve, përmbushjen e detyrimeve përkatëse dhe realizimin e ndërhyrjeve të parashikuara.

Rishpërndarja e fondeve për këto zëra synon të sigurojë vijueshmërinë e shërbimeve publike, përmbushjen e detyrimeve të institucionit dhe realizimin e objektivave të përcaktuar në buxhetin e vitit 2026.
Faleminderit per bashkepunimin.

Grislanda Bajraktari
Përgjegjëse Finance

Sahit Meshi
Drejtor Finance

Aida Bera
Përgjegjëse Juridiku

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

KRYETAR
Miftar DAUTI